


FONDI RAIFFEISEN PRESTIGJ



TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Janar 2018

Informacion bazë

Menaxhimi i Fondit	Raiffeisen INVEST
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	0%
Komision Administrimi në vit	1.25%
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitali të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.


Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta




Fondi është në kategorinë e dytë të Profili i Rrezikut dhe Përfitimit.

Të dhëna për Fondin në 31.01.2018

Vlera Neto e Aseteve	55,195,616,305
Numri i investitoreve	25,933
Cmimi i Kuotes	1,431.7284
*Kthimi vjetor nga investimi (31.01.2017 - 31.01.2018)	3.44%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve ne 31 Janar 2018



Ne kuader te politikës se investimit te fondit Prestigj, investimet do te kryhen kryesisht ne bono dhe obligacione thesari, te emetuara dhe garantuara nga Qeveria shqiptare, permes pjesemarrjes ne ankandet e tregut primar. Ankandet e letrave me vlere te emetuara ne Leke nga Qeveria e Republikës se Shqipërisë jane relativisht te shpeshta: Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; Obligacionet 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj.

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
<i>Bono Thesari</i>	24.72%
<i>Obligacione Thesari</i>	67.93%
<i>Depozita / Llogari rrjedhese</i>	6.89%
<i>Marreveshje të Riblerjes - Repo</i>	0.47%

Strategjia e investimeve nuk ka pesuar ndryshime dhe Fondi ka investuar gjate muajit Janar ne tregun primar ne bono dhe ne obligacion thesari.


Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 55,20 miliardë në datë 31 Janar 2018.

Ecuria e normave te interesit te letrave me vlere te Qeverise Shqiptare gjate muajit Janar

Gjate muajit Janar, normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare vijuan trendin rrites te muajve te meparshem, por jo per te gjitha maturitetet. Keshtu, yield-i mesatar i ponderuar i Bono Thesari 3 muaj u rrit me 12 pike baze krahasuar me ankandin e fundit qe ishte mbajtur ne Janar 2017 duke arritur nivelin e 1.34%. Ndersa yield-i mesatar i ponderuar i Bono Thesarit 12 muaj qendroi pak a shume stabel ne nivelin 2.656%.

Per sa u takon obligacioneve qeveritare, ankandet qe u zhvilluan gjate muajit Janar ishin ato te obligacionit 2, 3 dhe 10 vjecar. Norma e obligacionit 2-vjecar u rrit me 10 pike baze duke arritur ne nivelin 3.35%. Nderkohe, rritjen me te madhe, prej 105 pikesh baze, e pesoi norma e interesit e obligacionit 3-vjecar, ankandi i te cilit nuk zhvillohej qe ne Prill te 2017. Keshtu, norma e interesit e obligacionit 3-vjecar rezultoi ne 3.75%. Se fundmi, norma e interesit e obligacionit me maturitet 10 vite qendroi e pandryshuar ne nivelin e 7.00%.


Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bono thesari 12 muaj dhe obligacioneve 2, 5, 7 dhe 10 vjet te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjecare Janar 2017 – Janar 2018.



Ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Janar 2018

Çmimi i kuotes se fondit Prestigj ne muajin Janar ka pesuar renie ne krahasim me muajt e meparshem dhe ka shenuar edhe renien e tij me te larte historike. Kjo renie ne vlere ka ardhur si pasoje e rritjes se normave te interesit ne treg te titujve te Qeverise shqiptare, kryesisht te obligacionit 3 vjecar, norma e interesit te se cilit pesoi nje rritje te konsiderueshme prej 1.05%. Cmimi i kuotes ka rene me 0.22% per periudhen 31 Dhjetor 2017 – 31 Janar 2018.

Kthimi vjetor neto i fondit per periudhen 31 Janar 2017 – 31 Janar 2018 eshte 3.44%. Ne krahasim me performancen gjate muajve te shkuar kjo shenon nje ulje, e cila i atribuohet rritjes se normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare. Nje rritje e tille ka nje impakt negativ mbi portofolin ekzistues te Fondit Prestigj. Megjithate performanca e fondit eshte shume me e larte se norma mesatare e tregut per depozitat 1 vjecare ne LEK qe per te njejten periudhe ka qene ne nivelin e 0.63%.



Fondi vazhdon të ketë të njëjten strukturë të portofolit të investimeve por duhet patur parasysh se norma e kthimit dhe vlera e investimit ndryshojnë në varesi të kushteve të tregut, vecanerisht ndryshimeve të normave të interesit të instrumentave financiare ku fondi investon.

Per pasojë, çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmone në rritje, por edhe mund të bjere si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmeria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Prestigj dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim maksimal nga investimi. Në këtë mënyrë investitorët shmangin rrezikun e humbjes nga lëvizjet afatshkurtëra të çmimit të instrumenteve financiare në treg dhe mundësinë e terheqjes nga fondi në momentin e gabuar.

Të dhënat për kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe bankierët e Raiffeisen Bank nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.